



RAPORTI GJYSMËVJETOR 2021, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) nuk ka kryer procesin e konsultimit publik për asnjë nga aktet e miratuara duke qenë se këto akte nuk plotësonin kushtet për t'iu nënshtruar këtij procesi sipas ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2. Analiza e konsultimeve të kryera në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka miratuar gjithsej 14 projektvendime, të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk ndodheshin në kushtet për t'iu nënshtruar konsultimit publik duke qenë se nuk janë akte për të cilat kërkohet detyrimisht konsultimi publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji nr.146/2014 rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik dhe asnjë nga aktet e miratuara nga MASR nuk hyn në kategoritë e përmendura më sipër.

Më poshtë renditen aktet e miratuara në gjashtë muajorin e parë të vitit 2021 duke parashtruar sqarimet përkatëse se pse këto akte nuk i janë nënshtruar konsultimit publik.

1. Vendim nr. 2, datë 05.01.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë”.
2. Vendim nr. 44, datë 27.01.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e departamentit federal të punëve të jashtme të Zvicrës, duke vepruar nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, mbi programin “Promocioni shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve kronike në shkolla”, faza përgatitore, një projekt bilateral bashkëpunimi dhe zhvillimi”.

3. Vendim nr. 107, datë 24.02.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit”.

Aktet e përmendura më sipër, bazuar në kufizimin e përcaktuar në shkronjën “b”, neni 4 i ligjit nr. 146/2014 nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, sepse janë marrëveshje dypalëshë ose shumëpalëshë dhe lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare.

4. Vendimi nr. 66, datë 03.02.2021 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të pasurisë së paluajtshme nr. 7/19, në zonën kadastrale 8525”.
5. Vendimi nr. 145, datë 10.03.2021 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.
6. Vendimi nr. 242, datë 14.04.2021 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e përfundimit të punimeve në stadiumin “Zeqir Ymeri”, Kukës”.
7. Vendimi nr. 298, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot “Për masat për nxitjen e të nxëniet, të vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve të shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Korçë për vitin shkollor 2021-2022”.
8. Vendimi nr. 344, datë 09.06.2021 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e bursave për nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2021–2022” .
9. Vendimi nr. 320, datë 02.06.2021 i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 881, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj”.
10. Vendimi nr. 372, datë 22.06.2021 i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 764, datë 20.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit fillor “Scuola Italiana a Tirana”.
11. Vendimi nr. 67, datë 03.02.2021 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e gjashtë anëtarëve në përbërje të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, të përzgjedhur me konkurrim publik”.

Aktet e përmendura më sipër nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik bazuar në kufizimin e përcaktuar në shkronjën “c” të nenit 4 të ligjit nr.146/2014, sepse janë akte me karakter individual pasi i drejtohen një apo më shumë subjekteve të përcaktuara individualisht.

12. Vendimi nr. 185, datë 25.03.2021 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.
13. Vendimi nr. 274, datë 12.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore”.
14. Vendim nr. 46, datë 27.01.2021 i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim””.

Aktet e përmendura më sipër nuk i janë nënshtruar konsultimit publik duke qenë se nuk hynë në kategorinë e projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik, por janë trajtuar me grupet e interesit të cilëve do t’u ndikonte në mënyrë të drejtëpërdrejt ose të tërthortë përmbajtja e këtyre akteve nënligjore.